



2459
78/1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. 6647 Prot. (D.B)

Tiranë, më 02.05.2024

Lënda : Kthim përgjigje

Drejtuar : Z. Dorian Matlija

Qendra " Res Publica"
Bulevardi " Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7

TIRANË

Në përgjigje të kërkesës tuaj, ardhur dhe protokolluar më datë 29.04.2024, pas verifikimeve të kryera në lidhje me procedimin penal Nr.160, viti 2020, rezulton se :

Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar nga ana juaj, ju informojmë se nuk është bërë njoftimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi ky organ kushtetues nuk është subjekt i procedimit penal në fjalë. Veç kësaj gjatë hetimit të këtij procedimi penal, nuk është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprës penale sipas nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale, emri i asnjë personi nën hetim.

Përsa i përket pyetjes së dytë, ju informojmë se gjatë procesit hetimor, nuk është kërkuar vënia në dispozicion e ndonjë akti shkresor/dokumenti nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Gjatë hetimit, është kërkuar informacion nga institucionet ku janë arkivuar dokumentat e paraqitura gjatë shqyrtimit të kandidaturave për Anëtarë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.84, viti 2016 " Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", sikurse janë Kuvendi i Shqipërisë dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI

